



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 251/2014
Datë: 5 shtator 2014

Në bazë të nenit 4 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Rregullores për Funkcionimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës Rregullores për Procesin e Rekrutimit, Emërimit dhe Ri-emërimit të Prokurorëve, në mbledhjen e mbajtur me datën 5 shtator 2014, Këshilli Prokurorial i Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

- I. Për shpalljen e konkursit të brendshëm për prokurorë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- II. Konkursi i brendshëm në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit shpallet për dy (2) pozita për prokurorë.
- III. Konkursi i brendshëm në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës shpallet për tre (3) pozita për prokurorë.
- IV. Konkursi i brendshëm do të përcaktoje kriteret e përcaktuara me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- V. Konkursi i brendshëm do jete i hapur 15 ditë pune dhe të drejte aplikimi kanë vetëm prokurorët që ushtrojnë funksionin e Prokurorit të Shtetit.
- VI. Obligohet Sekretariati dhe Njësi të Shqyrtimit e Përformancës së Prokurorëve që konkursi i brendshëm të publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, si dhe në ueb faqën e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

VII. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikoj në ueb faqën e KPK-së dhe PSh-ës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Sylë Hoxha
Kryetar i Këshillit Prokurorial

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të ZKPSH;
- Arkivit të PSH-së/KPK-së.